





SYLABUS

PROGRAMI MËSIMOR

Administrata Publike dhe Manaxhimi i Resurseve
Humane

LËNDA: VETQEVERISJA LOKALE

VITI AKADEMIK 2022/2023

PROGRAMI STUDIMOR: ADMINISTRATA PUBLIKE

EMRI I LËNDËS VETQEVERISJA LOKALE

FAKULTETI:

FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE

DEPARTAMENTI:

VETQEVERISJA LOKALE

SHIFRA E LËNDËS:

FSAP7Z2

NIVELI & STATUSI:

6 ECTS Kredi
Studime deridiplomike/ VJESHTË 2022
2 orë Ligjeratë dhe 2 ore Ushtrim

LIGJËRUESI I LËNDËS:

Dr. Marta Vejseli
E-mail: marta.vejseli@unt.edu.mk

Objekti B , B4

ORARI I MËSIMDHËNIES:

Ligjerata dhe ushtrime:
E Hene 16:00-17:30
E Hene 17:45-19:15

WEBMAIL

Si instrument kryesor për komunikim do të shfrytëzohet Webmail-in. Kontrollimi i email-it është i detyrueshëm.

Googleclassroom

Datat e provimeve dhe informata tjera të rëndësishme për fakultetin do të publikohen në (Google-Classroom) Info Teknik – **l4asait**

KONTURAT E LËNDËS DHE QËLLIMET

“Vetëqeverisja lokale” përfshin:

- Koncepti dhe funksionimi i komunave dhe organve të saj (definicionet: komuna, vetëqeverisja lokale, administrata publike);
- Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale: rëndësia, zbatimi në nivelin nacional;
- Komunitet si vetëqeverisje bazë e territorit lokal (themelimi, organet, fusheveprimi, kompetencat);
- Demokracia lokale dhe zgjedhjet lokale;
- Financimi komunal dhe kontrolli shtetëror mbi vetëqeverisjen lokale;
- Udhëheqja politike lokale;
- Teritoret e vetëqeverisjes lokale në RMV;
- Komunitet në sistemin tonë ligjor, instrumentet për promovim të zhvillimit ekonomik rajonal;
- Ligjet e RMV dhe ndërkombëtare të vetëqeverisjes lokale në RMV dhe vendeve të tjera evropiane.

Mësimi i lëndës “Vetëqeverisja lokale” studentëve do t’ju ofrojë:

- Pajisja e studentëve me njohuritë mbi nocionet dhe fenomenet lidhur me komunitet si njësi të qeverisjes lokale në sistemin kushtetues-politik të RMV-së, përfshi këtu edhe qëndrimet e ndryshme teorike dhe praktike lidhur me to;
- Pajisja e studentëve me njohuritë konkrete mbi qeverisjen lokale si një disiplinë shkencore juridikepolitike;
- Nëpërmjet kësaj lënde studentët duhet të aftësohen lidhur me njohjen teorike dhe konkrete të konceptit kushtetues së organizimit të sistemit të qeverisjes lokale, në përgjithësi dhe të RMV-së në veçanti;
- Nxitja e mendimit analitik dhe kritik të studentët lidhur me problemet me të cilët ballafaqohet sot qeverisja lokale;

-Në fund të ligjeratave studentët do të jenë në gjendje të bëjnë dallimet themelore dhe substanciale të institucioneve të qeverisjes lokale, ndërlidhja e tyre në praktikë si dhe funksionimi i tyre sipas kushtetutës dhe ligjeve;

-Të bëjnë dallimet e duhura teorike dhe praktike të nocioneve, kuptimeve dhe dukurive me karakter të qeverisjes lokale;

-Të shpjegojnë dhe analizojnë proceset e ndryshme në kuadër të komunave si njësi të qeverisjes lokale ku komuniteti lokal i realizon kërkesat dhe nevojat e tij me vlerë dhe rëndësi vitale në praktikë;

-Të punojnë me ligjet përkatëse dhe të jenë të aftësuar ti interpretojnë këta ligje në ditën e përditshme / në praktikë.

REZULTATET E NXËNIES

Përshkrimi i i deskriptorëve për rezultatet e nxënies për këtë lëndë:

KATEGORIA	REZULTATET E NXËNIES	METODOLOGJIA VLERËSIMIT	%
Njohuritë dhe të kuptuarit	<ol style="list-style-type: none"> Ka njohuri themelore mbi institutet, nocionet, vlerat dhe parimet e qeverisjes lokale; Ka dije solide mbi zbatimin e parimeve themelore juridike në sferën e qeverisjes lokale; Ka njohuri mbi kontekstin social, ekonomik, politik dhe historik ku veprojnë normat juridike nga legjislacioni që i referohet qeverisjes lokale. 	Përmes aktivitetit dhe interesimit të studentit në ligjerata; prezantimeve, pyetjeve të drejtpërdrejta të profesorit dhe përgjigjeve të studentit, debateve, diskutimeve dhe provimit.	25
Zbatimi i njohurive dhe të kuptuarit	<ol style="list-style-type: none"> Identifikon dhe i zbaton nocionet, parimet dhe ligjshmëritë themelore juridike; Identifikon problemet themelore teorike juridike që ndërlidhen me përmbajtjen e qeverisjes lokale; 	Përmes aktivitetit dhe interesimit të studentit në ligjerata; prezantimeve, pyetjeve të drejtpërdrejta të profesorit dhe përgjigjeve të studentit, debateve, diskutimeve si dhe ushtimeve dhe provimit.	25

	3. Perdor menytrat e interpretimit per te zbatuar / interpretuar ligjin		
Sjellja e gjykimeve	Identifikon, interpreton, analizon dhe i zgjidh problemet themelore juridike nga sfera e qeverisjes lokale; Identifikon parimet themelore juridike mbi organizimin, strukturën, kompetencat dhe funksionimin e qeverisjes lokale në përgjithësi.	Përmes aktivitetit dhe interesimit te studentit ne ligjerata; prezantimeve, pyetjeve të drejtpërdrejta te profesorit dhe pergjigjeve te studentit, debateve, diskutimeve si dhe ushtimeve dhe provimit.	25
Shkathësitë komunikuese	1. Debaton me shkrim dhe gojarisht mbi tema të ndryshme juridike në përgjithësi që dalin nga përmbajtja e qeverisjes lokale.	Aktiviteti dhe punë në grupe	10
Shkathësitë e të mësuarit	1. Analizë kritike të rasteve të studimit të paraqitura në fund të çdo ligjërata 2. Shfrytëzim efektiv të bibliotekës dhe të dhënave nga interneti në lidhje me lëndën	Aktiviteti në klasë dhe mendimi kritik i studentëve	15
Totali			100

PËRSHKRIM PËRMBLEDHËS I VLERËSIMIT

PËRSHKRIMI	%
Prezenca	10
Aktiviteti	10
Detyrat e shtëpisë	/
Detyra tjera	?
Punim seminarik	/
Rast studimi	?
Prezentim	20
Ese	?
Punim laboratorik	?
Projekt	?

Provimi i gjysmë-semesterit	20
Provimi përfundimtarë	40
Totali	100

DETAJE PËR INSTRUMENTET E VLERËSIMIT

METODAT E MËSIMDHËNIES DHE NXËNIES

Lënda Vetqeverisja Lokale ka 6 kredi sipas ECTS sistemit. Mënyra e të mësuarit në lëndën Vetqeverisja lokale do të jetë nga 2 orë ligjërata në javë për 12 javë. Nje ditë në javë nga dy orë të plota janë caktuar për konsultime me studentë, ku mund të punohet në mënyrë plotësuese pa kurrfarë kufizimi, studentët mund t'i shfrytëzojnë edhe ditët tjera për konsultime shtesë.

Forma e punës sime në lëndën Vetqeverisja Lokale është puna frontale (ballore) sepse leksionet i zhvilloj në grupe të mëdha të studentëve. Kjo formë më ndihmon që të t'i ikë pasivitetit të studentëve dhe në të njëjtën kohë arrijë të nxisë mësim kreativ-problemor duke punuar me tërë klasën.

PROVIMET

Vlerësimi do të realizohet nëpërmes kolokiumit të parë dhe provimit përfundimtar.

Pyetjet mundet të kenë njërin nga format vijuese:

- Zgjedhje e shumëfishtë
- Esej
- Saktë/gabim
- Plotëso vijat e zbrazta
- Përgjigje të shkurta ndaj pyetjeve të parashtruara

DETYRAT

Në suaza të lëndës, studentët do të ngarkohen me detyra nga ana e bartësit të lëndës, si dhe gjatë realizimit të ushtrimeve praktike. E gjithë kjo, me qëllim që studentët në mënyrë permanente, njohuritë e përfituara në ligjëratë dhe shembujt e trajtuar në ushtrime, t'i zbatojnë në shembuj konkret.

PREZENCA DHE RREGULLAT

Prezenca e studentëve në klasë është e obligueshme. Po qe se shfaqet një situatë për shkak të së cilës ju do të duhet të mungoni (p.sh. për shkak të ndonjë sëmundjeje), ju duhet të na njoftoni sa më shpejt të jetë e mundur. Secili student është I DETYRUAR të ndjekë të paktën 70% të numrit të përgjithshëm të orëve të lëndës (ligjërata dhe ushtrime), për të mundur të hyjë në provimin përfundimtar. Cilido student që nuk i përmbush këto kritere, NUK do të ketë të drejtën të hyjë në provimin, provimin shtesë (make-up) e as të regjistrohet në shkollën verore dhe do të duhet të ri-ndjekë lëndën.

Plagjiatura, etika akademike dhe standardet e sjelljes

Çfarëdo lloji i plagjiaturës nuk do të tolerohet në këtë lëndë. Çfarëdo detyre e dorëzuar nga studenti që është kopjuar (pra, që tenton t'i shfrytëzojë idetë ose argumentet e dikujt tjetër si të vetat), do të marrë zero (0) pikë. Studentët që bëjnë copy/paste nga Interneti nuk do të marrin asnjë pikë (pra, notë zero), pa përjashtim. Unë e mbaj të drejtën që të testoj gojarisht studentin për përmbajtjen e detyrës së tij, nëse kam dyshim që projekti/detyrat e tij janë kopjuar ose vjedhur dhe se të njëjtat nuk

janë punë origjinale e studentit. Pritet që studentët të sillen në mënyrë profesionale dhe të njerëzishme. Studentët mund t'i diskutojnë detyrat laboratorike në mënyrë të përgjithshme me të tjerët, mirëpo zgjidhjet duhet të bëhen në mënyrë të pavarur. Puna e notuar duhet të jetë ekskluzivisht e studentit në fjalë. Studentëve nuk u lejohej të përshkruajnë ose kopjojnë zgjidhjen e një detyre nga një person tjetër, libër ose burim tjetër (p.sh. ueb faqe). E njëjta rregull vlen edhe për detyrat e shtëpisë që duhet të notohen. Kopjimi i punës së tjetërkujt nuk do të tolerohet. Profesorët do të raportojnë pandershmëri akademike dhe çfarëdo forme tjetër të shkeljes së standardeve të sjelljes te Komiteti për Plagjiaturë pranë fakultetit përkatës.

PËRDORIMI I FACEBOOK-UT/ UEB-IT/ KOMPJUTERËVE/ TELEFONAVE CELULARË

Gjatë tërë kohëzgjatjes së orës mësimore, vëmendja juaj pritët të jetë e përqendruar në mësim dhe detyrat në klasë. Megjithëse jemi të vetëdijshëm se jeni të aftë për të bërë shumë punë përnjëherë, ne kërkojmë që ju megjithatë të përqendrohëni në një gjë gjatë orës mësimore. Duam t'i eliminojmë pengesat gjatë orës mësimore. Në shenjë mirësjelljeje, kërkojmë nga ju të shkyçni telefonat celularë gjatë orëve dhe provimeve.

TABELA E SHKALLËS SË NOTAVE

SHKALLA E NOTAVE	PËRSHKRIMI	NOTA
95% - 100%	Mrekullueshëm	10 (Dhjetë) A
85% - 94%	Shkëlqyeshëm	9 (Nëntë) B
75% - 84%	Shumë mirë	8 (Tetë) C
65% - 74%	Mirë	7 (Shtatë) D
51% - 64%	Mjaftueshëm	6 (Gjashtë) E
0% - 50%	Pamjaftueshëm	5 (Pesë) FX
	E pakryer *	IN
	Pa të dhëna *	NR

BIBLIOGRAFIA

TEKSTET PËR LEXIM (TEKSTET THEMELORE)

TË DETYRUESHME:

1. Kompilacion – permbledhje materijalesh tekstuale nga sfera e qeverisjes lokale;
2. Esat Stavileci, Agni aliu, Qeverisja Lokale, Tetove-Prishtine, 2009;
3. Konrad Adenauer Stiftung, Lokalna Samouprava, Gordana Siljanovska – Davkova, Vladimir Mitkov, T. Karakamisheva-Jovanovska, A. Spasenovski, M. Krtolica
4. Ligji për vetëqeverisjen lokale (2002),
5. Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale (2004),
6. Ligji për organizimin territorial të Vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Maqedonisë (2004 dhe 2014)
7. Ligji për inspektoratin shtetëror të vetëadministrimit lokal të RMV-se (2010)

ORARI TENTATIV

JAVA	MODULET	PËRSHKRIMI
JAVË PËR MESIMDHËNIE DHE MESIMNXËNIES		
1	LIGJËRATAT	Hyrje, njoftim me studentet, prezentim i sylabusit
2	LIGJËRATAT	Kuptimi dhe parimet themelore te vetqeverisjes lokale
3	LIGJËRATAT	Karakteristikat dhe kompetencat e vetqeverisjes lokale
4	LIGJËRATAT	Finansimi i Komunes, sistemi tatimor i nivelit lokal
5	LIGJËRATAT	Organet e Komunes dhe fusheveprimi i tyre
6	LIGJËRATAT	Format e pjesmarrjes se drejtperdrejt te qytetareve ne vendimarrje ne njesite e qeverisjes lokale
7	LIGJËRATAT	Karta Evropiane dhe e drejta e BE-se ne lidhje me vetqeverisjen lokale, Komisioni Evropian dhe Keshilli i Evropes
8	LIGJËRATAT	Kollokvium
9	LIGJËRATAT	Prezentim i studenteve, tema: Vetqeverisja Lokale ne shtetet e BE-se (secili student prezenton nga nje shtet)
10	LIGJËRATAT	Ligjmëria e aktvendimeve te Komunes
11	LIGJËRATAT	Mbikqyrja e organeve se puneve komunale
12	LIGJËRATAT	Mbrojtja ligjore e akteve te komunes
13	LIGJËRATAT	Planifikimi urbanistik
JAVË PËR PROVIME DHE MËSIM KLINIK		
14	PERSERITJE TË LIGJËRATAVE	
15	PROVIMI PËRFUNDIMTAR	Provimi përfundimtar

SHËNIM:

Java e provimeve dhe ajo e mësimit klinik mund të ndryshojnë.

USHTRIMET e cdo ligjerate do te jene perseritje e ligjerates perkatese dhe parashtrim pyetjesh